

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 285/11 Prot.

Pogradec, më 23 . 06 .2022

VENDIM

NR. 64 , DATË 22 . 06 .2022

PËR

MIRATIMIN E NORMAVE, KRITEREVE, RREGULLAVE DHE
PROCEDURAVE PËR MARRJEN ME QERA, SIPËRFAQE TOKE/TRUALL
PËR QËLLIME MAGAZINIMI DHE SHËRBIMI, PËR NEVOJAT E
BASHKISË POGRADEC DHE NDERMARRJEVE NË VARËSI TË SAJ.


Në mbështetje të; shkronjave "a" dhe "c" të pikës 1.2 të nenit 9, shkronjës "k" dhe shkronjës "n" të nenit 54 të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, shkronjës "a" të pikës 1 të nenit 7 të Ligjit Nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", Ligjit Nr.10926, date 08.07.2011, "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin" ,I ndryshuar, nenit 801 e vijues të Ligjit Nr. 7850, datë 29.7.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", I ndryshuar, si dhe bazuar në relacioni I paraqitur, me propozim të Kryetarit të Bashkisë..

KËSHILLI I BASHKISË

VENDOSI :

1. Të miratojë normat ,kriteret, rregullat dhe procedurat për marrjen sipërfaqe toke bujqesore /truall, për qëllime shërbimi, ruajtje, grumbullimi dhe magazinimi të aktiveve, për nevojat e Bashkisë Pogradec dhe Ndermarrjeve ne varësi të saj.
2. Sipërfaqja tokë bujqesore ose truall që mund të merret me qera, të jetë jo më pak se 500 (Pesëqind) m2 dhe jo më shumë se 5 000 (Pesëmijë) m2, Brenda secilës të jetë edhe një objekt I cili do të shërbejë zyrë për punonjësin – roje.
3. Vlera e qirase mujore me të cilën do të fillojë procedura e konkurimit të përcaktohet pas testimit të vlerës së tregut për qeratë e tokes bujqesore dhe/ose truallit në territorin e Bashkisë Pogradec.
4. Procedura e konkurimit për marrjen e sipërfaqes dhe objektit me qera, t'I nënshtrohet hapave të mëposhtëme:

4.1 Struktura e posacme e krijuar me urdher të Kryetarit të Bashkisë Pogradec, të hartojë dhe të publikojë njoftimin për zhvillimin e procedures së konkurimit në buletinin e publikimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe në këndin e publikimeve pranë Bashkisë Pogradec.



4.2 Afati I paraqitjes së ofertave të zgjasë të paktën 10 (Dhjetë) ditë që nga data e publikimit të njoftimit në buletin e APP-së.

4.3 Komisioni I Vlerësimit të Ofertave, I krijuar me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Pogradec, brenda 5 (Pesë) ditëve nga data e hapjes së ofertave, të shqyrtojë ofertat e kualifikuara si të rregullta dhe të vlerësojë me çmim më të ulët ofertën/ofertat, dhe të hartojë vendimin për renditjen e ofertueseve.

4.4 Subjektet pjesëmarrëse në konkurrim, t'iu njihet e drejta të ankohen, me shkrim, pranë Kryetarit të Bashkisë Pogradec, kundër vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, brenda 7 (Shtatë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit të vendimit.

4.5 Në përfundim të afateve të ushtrimit të së drejtës së ankimimit, kryetari I K.V.O I paraqet Kryetarit, njëra por përmbledhës dhe I propozon për miratimin e fituesit të procedurës konkurruese.

4.6 Në përfundim të hapave të mësipërme, autorizohet Kryetari I Bashkisë Pogradec për nënshkrimin e kontratës së qirasë.

5. Kohëzgjatja e kontratës së qerasë të jetë deri në 5 vjet.

6. Për zbatimin e vendimit të ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike, Administrata e Bashkisë Pogradec dhe Ndermarrjet në varësi të Bashkisë Pogradec.

7. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

8. U shpall sot më datë 22.06. 2022.

KRYETARI I KËSHILLIT

Sotiraq MANGËRI

